



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 24.30.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR
TË AUTORITETIT RREGULLATIV TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm - Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Ilir Abazi - Udhëheqës i ekipit të auditimit, me anëtarët e ekipit Mirlinda Beqiri dhe Hysen Boqolli, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit -Bujar Sejdiu.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	13
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	21
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	22
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	25
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	26

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetore të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 21/11/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes.

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se vlera e llogarive të arkëtueshme e shpalosur në Pasqyrat Vjetore Financiare është nënvlerësuar për 512,428€, ndërsa pasuria jokapitale është mbivlerësuar për 18,483€.


Për më gjerësisht shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Kryetarin e Bordit dhe ekipin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimit të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Kryetarit të Bordit

Kryetari i Bordit ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të e Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësi dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Vlera e llogarive të arkëtueshme e shpalosur në PVF është nënvlerësuar për 512,428€ sepse në bilancin e llogarive të arkëtueshme ishin prezantuar vetëm të arkëtueshmet deri me 31.12.2015 në vlerë 270,609€ duke përjashtuar faturimet e muajit dhjetor 2016; dhe
- Pasuria jokapitale e shpalosur është mbivlerësuar për 18,483€ sepse zhvlerësimi i vjetor i pasurisë jokapitale nuk ishte llogaritur me kohë.

Opinionin jonë nuk modifikohet për këto çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Kryetari i Bordit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ARKEP-it.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

ARKEP kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga OB;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.06/2011;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara publike.

Në draft PFV ishin të nevojshme disa korrigjime në shpalosje dhe kemi dhënë disa sugjerime për të përmirësuar ato, pasi:

- Shpalosjet rreth të hyrave vetanake të pashfrytëzuar nuk ishin prezantuar drejtë, dhe
- Pasuritë jokapitale nuk ishin shpalosur në vlerën e saktë.

Megjithatë, edhe pas korrigjimeve të PVF-ve, kemi identifikuar shpalosje jo të saktë të llogarive të arkëtueshme dhe pasurisë jokapitale. Të gjeturat nxjerrin në pah mungesën e rishikimit kritik të draft PVF-ve nga menaxhmenti, i cili është i nevojshëm për të konfirmuar saktësinë dhe plotësinë e tyre si dhe për të konfirmuar aplikimin e të gjitha kërkesave të tjera për raportim.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF mund të konsiderohet e saktë, ndonëse ekzistojnë gabime që nuk kanë ndikuar në modifikimin e opinionit të auditimit.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjet e theksuara të baza për opinion, ne japim rekomandimin si në vijim:

Rekomandimi 1 Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore që ARKEP të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vetëvlerësimit që plotësohet nga ARKEP siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në lidhje me menaxhimin e rrezikut, raportimin menaxherial dhe përmbushjen e kërkesave rreth vetëvlerësimit të organizatës pasqyron një situatë pozitive. ARKEP është në proces të zbatimit të rekomandimeve si dhe ka përgatitur raportin e menaxhimit të rrezikut duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj.

Megjithatë, ekzistojnë disa mangësi brenda organizatës veçanërisht në lidhje me mungesën e statutit dhe rregullores së re të punës.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 ka rezultuar me pesë (5) rekomandime kryesore. ARKEP ka përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, dy (2) rekomandime janë zbatuar, ndërsa tri (3) të tjera janë në proces të zbatimit. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III. Inkurajojmë Kryetarin e Bordit që të vazhdojë me zbatimin e të gjitha rekomandimeve tona.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.2 Pyetëtori i vetëvlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vetëvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetëvlerësimit të MFK-së të dorëzuar në MF, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit.

Ne kemi përmbledhur rezultatet e punës sonë për ARKEP-in më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetëvlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Si pjesë e auditimit tonë, ne kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me pesë (5) komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi konfirmuar se:

1. Pyetësi i vetëvlerësimit i plotësuar nga organizata e pasqyron gjendjen ekzistuese të proceseve të vendosura në organizatë;
2. Procesi i menaxhimit të rrezikut është vendosur. Rreziqet janë identifikuar, është bërë përshkrimi i tyre, janë përcaktuar veprimet që duhet të ndërmerren, afatet e zbatimit dhe stafi përgjegjës në menaxhimin e tyre;
3. Proceset efektive të monitorimit si dhe strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit konsiderohen të vendosura nga menaxhmenti dhe kjo mbështetet me dëshmi; dhe
4. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen të vendosura dhe dëshmitë që na janë dhënë e mbështesin këtë konkluzion.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit ARKEP operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.3.1 Hartimi i rregulloreve të punës

Ligji 04/L-109 për komunikimet elektronike përcakton që ARKEP respektivisht Bordi duhet të aprovojë Statutin dhe Rregulloren e brendshme të punës në të cilat bazohet funksionimi i saj.

Çështja 2 – Mungesa e Statutit dhe Rregullores së punës – Prioritet i lartë

E gjetura Statuti dhe Rregullorja e punës janë dokumente vitale për funksionimin efektiv të ARKEP-it. Auditimi ynë ka identifikuar që ARKEP ende nuk e ka aprovuar draft Statutin e Autoritetit dhe Rregulloren e re të Punës siç është përcaktuar me legjislacionin përkatës.

Rreziku Vonesa në aprovimin e Statutit dhe Rregullores rezulton në vështirësi në menaxhimin e përditshëm të aktiviteteve të organizatës dhe zhvillimin e një procesi adekuat të mbikëqyrjes. Për më tepër, kjo redukton përcjelljen efektive të përmbushjes së objektivave dhe vizionit të organizatës si një ndër kushtet esenciale të qeverisjes së mirë.

Rekomandimi 2 Kryetari i Bordit duhet të analizojë arsyet e vonesave në përmbushjen e kërkesave ligjore për aprovimin e draft dokumenteve të brendshme dhe të sigurojë që deri më 1 tetor draftet e Statutit dhe Rregullores së brendshme të punës t'i paraqiten Bordit për aprovim.

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti duhet të zbatojë një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare dhe ato të kontrollit funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara. Menaxhmenti ka vendosur linja të komunikimit dhe njoftohet përmes raportimeve për aktivitetet operacionale dhe financiare të organizatës.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

ARKEP si organizatë e vogël buxhetore nuk plotëson kriteret e nevojshme ligjore për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB). Sidoqoftë, ARKEP i nënshtrohet auditimit të brendshëm nga Njësia Qendrore Harmonizuese (NjQH) në kuadër të MF-së.

Gjatë vitit 2016 nuk ishte zhvilluar ndonjë auditim i brendshëm. Në prill të vitit 2017, pas kërkesës nga ARKEP për shërbime të auditimit të brendshëm, NjQH/AB kishte filluar auditimin e aktiviteteve të vitit 2016. Fokus i auditimit ishin buxheti, të hyrat dhe shpenzimet, personeli përfshirë listat e pagave, aktivitetet e prokurimit publik, si dhe menaxhimi i rreziqeve.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

ARKEP në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit. Në vitin 2016, ka përdorur 97% të buxhet final me një përmirësim për 2% në krahasim me vitin paraprak. Kjo tregon një trend pozitiv në menaxhimin e buxhetit.

Megjithatë, edhe përkundër angazhimeve të menaxhimentit në një numër fushash nevojiten zhvillime të mëtejshme. Menaxhimi i personelit mbetet fusha që kërkon vëmendje të shtuar të menaxhimentit sepse nuk janë zbatuar si duhet rregulloret. Fushat tjera ku nevojiten më shumë përmirësime janë shpenzimet për mallra dhe shërbime, menaxhimi i llogarive të arkëtueshme dhe pasurisë.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e realizuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat	4,665,000	4,665,000	4,787,572	19,278,968	3,941,666
Totali	4,665,000	4,665,000	4,787,572	19,278,968	3,941,666

Të hyrat e inkasuara nga ARKEP transferohen në Buxhetin e Kosovës (BK). Të hyrat e vitit 2015 janë më të larta për shkak të të hyrave në shumë 14,813,763€ për dhënien e të drejtës së shfrytëzimit të radio spektrit frekuencor për periudhën 2015-2019. Kjo e drejtë është dhënë për periudhën dhjetor 2015 deri në korrik 2019 me çmim total prej 33,391,463€ ndërsa pjesa e mbetur do të paguhet gjatë viteve të ardhshme.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	834,368	777,884	757,975	617,944	780,465
Granti i Qeverisë - Buxheti	834,368	777,884	757,975	612,468	776,034
Donacionet e Jashtme	-	-	-	5,476	4,431

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar 56,483€. Zvogëlimi i buxhetit është aplikuar pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2016, ARKEP ka shfrytëzuar 97% të buxhet final ose 757,975€, me një përmirësim prej 2% krahasuar me vitin 2015. Buxheti është realizuar në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenz. e fondeve sipas kategorive ekonomike:	834,368	777,885	757,975	617,944	780,465
Pagat dhe Mëditjet	424,436	409,236	390,655	367,115	320,111
Mallrat dhe Shërbimet	287,232	291,440	290,715	239,836	249,543
Shërbimet komunale	12,700	10,702	10,098	10,993	11,213
Investimet Kapitale	110,000	66,507	66,507	-	199,598

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti për paga dhe mëditje ishte zvogëluar për 15,200€ me vendim të Qeverisë. Ky zvogëlim kishte ndodhur për shkak që buxheti nuk ishte shpenzuar pasi që nuk ishin plotësuar dy pozita të lira të punës;
- Buxheti për mallra dhe shërbime është rritur me vendim të Qeverisë për 4,208€, si rezultat i nevojave shtesë për mallra dhe shërbime. Në anën tjetër buxheti për shpenzime komunale është zvogëluar për 1,998€ kjo me vendimin e Qeverisë për reduktimin e ndarjeve buxhetore; dhe
- Zvogëlimi i buxhetit për investime kapitale për 43,493€ është bërë përmes procesit të rregullt të rishikimit buxhetor dhe vendimeve të Qeverisë. Zvogëlimi i buxhetit ka rezultuar si pasojë e dështimit të procedurave të prokurimit për projektet kapitale të udhëhequra nga Agjencia Qendrore e Prokurimit.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara në 2016 ishin në vlerë 4,787,572€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, licencat, të hyrat nga numeracioni dhe përdorimi i frekuencave, dhe pagesat për dënimet ekonomike të vendosura nga ARKEP.

Tabela.4 Të hyrat e realizuara sipas llojit (në €)

Kodi Ekonomik	Lloji i të hyrës	Realizimi 2016	Realizimi 2015
50019	Taksa tjera administrative	3,473	2,880
50107	Gjobat tjera	2,435	12,007
50290	Licenca për afarizëm	4,781,664	19,264,081
Totali		4,787,572	19,278,968

Çështja 3 - Regjistrimi i të hyrave - Prioritet i mesëm

E gjetura Edhe pse ARKEP ka regjistër të plotë dhe të saktë të të hyrave që inkason, auditimi ynë ka identifikuar dobësitë në vijim:

- Shuma 305,000€ e inkasuar më 05 janar 2016 ishte regjistruar në SIMFK më 14 janar 2016. Vonesa janë hasur edhe në raste tjera; dhe
- Të hyrat regjistrohen në fondin 21 për të hyrat vetanake ndonëse të gjitha të hyrat e inkasuara transferohen në Buxhetin e Kosovës. ARKEP aktualisht nuk i shfrytëzon të hyrat e mbledhura, ndërsa shpenzimet financohen nga granti qeveritar apo Buxheti i Kosovës.

Rreziku Vonesat në regjistrimin e të hyrave dhe regjistrimi në fondet joadekuate mund të shkaktojnë paqartësi financiare rreth vlerës së të hyrave të inkasuara si dhe menaxhimit të përgjithshëm të të hyrave përfshirë përmbushjen e kërkesave për raportim financiar.

Rekomandimi 3 Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se regjistrimi i të hyrave në SIMFK bëhet në baza ditore pas pranimit të raporteve bankare në pajtim me Rregullën Financiare 03/2010 për të hyrat. Meqenëse të hyrat e mbledhura dedikohen për Buxhetin e Kosovës, atëherë regjistrimi i të hyrave në SIMFK duhet të bëhet në fondin burimor 10 - Buxheti i Kosovës.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Në fund të vitit ARKEP kishte 37 të punësuar nga 39 sa ishin aprovuar me Ligjin e Buxhetit për vitin 2016, si dhe një punonjës jashtë listës së pagave që kompensohet nga buxheti për mallra dhe shërbime. Shpenzimet vjetore për paga e mëditje ishin 390,655€, apo 95% e buxhetit final.

Çështja 4 – Rekrutimi i personelit – Prioritet i mesëm

E gjetura Testimet tona kanë gjetur që menaxhmenti nuk i ka zbatuar kontrollet ekzistuese në mënyrë efektive për të siguruar pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret relevante. Si pasojë, janë identifikuar dobësitë në vijim:

- ARKEP ka angazhuar një punonjës/shofer me kontratë pune për kohë të caktuar, përkatësisht në afatin e mandatit të Kryetarit të Bordit. Angazhimi i tij ishte bërë pa procedurë të rekrutimit. Kompensimi i punonjësit në vlerë 465€ për muaj bëhet nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve; dhe
- Në konkursin publik për Zyrtar të Teknologjisë Informativë, si kriter punësimi ishte përvoja e punës, pa specifikuar numrin e viteve të përvojës. Një nga kandidatët kishte ofruar dëshmi rreth përvojës së punës shumë më të gjatë se sa kandidati i përzgjedhur. Poashtu, kontrollimi/vlerësimi i testit me shkrim për kandidatin e përzgjedhur nuk ishte nënshkruar nga dy (2) anëtarë të komisionit vlerësues, ndonëse raporti përfundimtar i kandidatëve ishte nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit. Kandidati i përzgjedhur ishte i angazhuar paraprakisht në ARKEP me marrëveshje për shërbime të veçanta pa ndonjë procedurë të përzgjedhjes/rekrutimit.

Rreziku Parregullsitë e hasura tregojnë për mungesë të kontrolleve në zbatimin e rregullave dhe procedurave ligjore për rekrutim. Punësimi i personelit duke anashkaluar kërkesat dhe procedurat ligjore bie në kundërshtim me ligjin dhe nuk siguron konkurrencë dhe trajtim të barabartë. Si rezultat, kandidatët mund të mos kenë përvojën dhe aftësitë e nevojshme dhe punët mund të mos realizohen me kompetencë dhe profesionalizëm.

Rekomandimi 4 Kryetari i Bordit duhet t'i rishikojë kontrollet lidhur me rekrutimin e stafit dhe, sipas nevojës, t'i forcojë ato për të siguruar që rekrutimi bëhet përmes një procesi meritore dhe transparent në pajtim me kërkesat ligjore. Kriteret e punësimit duhet të jenë të qarta dhe të matshme për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët.

Çështja 5 – Dobësi në menaxhimin e personelit – Prioritet i mesëm

E gjetura	<p>Testimet e bëra në fushën e menaxhimit të personelit kanë identifikuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Një pozitë udhëheqëse mbahej me Ushtrues Detyre (U.D) që nga muaji mars 2016 duke tejkaluar kështu limitin prej tre (3) muajsh të përcaktuar me Ligjin për Shërbimin Civil; dhe • ARKEP, me një vendim nga Bordi, kishte paguar mbajtësen e procesverbaleve (shërbyes civil) për takimet e Bordit nga 40€ për secilin takim të mbajtur. Në një rast tjetër pagesa shtesë në vlerë 200€ për kompensim të pjesëmarrjes në takim nuk është mbështetur mjaftueshëm me dëshmi se një takim i tillë është mbajtur; dhe • Akt emërimet nuk ishin azhurnuar duke mos reflektuar ndryshimet/ rritjet në paga bazuar në vendimin e Qeverisë të vitit 2014.
Rreziku	Mbajtja e pozitës me U.D për një kohë të gjatë nuk siguron kryerje të funksioneve me përgjegjësi dhe kompetencë të plotë. Pagesa për kompensime jo në pajtim me rregulloret dhe ligjet në fuqi mund të rezultojnë me shpenzime të parregullta për ARKEP-in.
Rekomandimi 5	Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se menaxhimi i personelit dhe pagesave bëhet në pajtim me procedurat dhe rregulloret relevante. Për pozitën e mbajtur me U.D. të bëhet një zgjidhje e qëndrueshme dhe në pajtim me kornizën ligjore.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë edhe ato komunale në vitin 2016 ishte 302,142€, ndërsa shpenzimi vjetor ishte 300,813€. Pjesa më e madhe e buxhetit për mallra dhe shërbime është shpenzuar për udhëtime zyrtare, qiranë e objektit, dhe shërbime kontraktuese tjera, etj.

Çështja 6 – Shpenzime të telefonisë mobile pa kontratë - Prioritet i mesëm

E gjetura	ARKEP vazhdon të shfrytëzojë shërbimet e telefonisë mobile pa ndonjë kontratë të lidhur përmes procedurave të prokurimit publik. Me vendim të Bordit në vitin 2013 janë përcaktuar limitet e shpenzimeve mujore për stafin profesional (20€) dhe për stafin administrativ (16€). Testimet tona kanë identifikuar se i tërë stafi pranon nga 20€ mbushje elektronike në muaj.
Rreziku	Shfrytëzimi i shërbimeve telefonike mobile pa ndonjë kontratë publike, përveç që është në kundërshtim me kornizën ligjore në fuqi, nuk siguron çmime konkurruese të tregut dhe mund të rezultojë në vlerë të ulët për paranë e shpenzuar aktual të telefonisë mobile në vend. Shfrytëzimi i shërbimeve përtej limiteve të caktuara rezulton me shpenzime të parregullta.

Rekomandimi 6 Kryetari i Bordit duhet të sigurojë që shërbimet e telefonisë mobile të shfrytëzohen konform kërkesave ligjore të prokurimit publik për të përfituar shërbime më cilësore dhe më ekonomike. Të gjithë zyrtarët duhet të pranojnë mbushje brenda limiteve të përcaktuara me vendimet/rregulloret në fuqi.

Çështja 7 - Mos zotim i mjeteve buxhetore me kohë - Prioritet i mesëm

E gjetura Auditimi ynë ka identifikuar që kontrata dy vjeçare për “*Qiranë e objektit të ARKEP-it*” me vlerë 4,480€ për muaj dhe kontrata publike kornizë tri (3) vjeçare “*Sigurimi fizik i objektit të ARKEP-it*” me vlerë të përgjithshme 31,428€ (apo 873€ për muaj) ishin nënshkruar pa u zotuar paraprakisht mjetet e nevojshme buxhetore. Zotimi i mjeteve buxhetore nuk është bërë me kohë, por pas çdo muaji, edhe pse ishte e mundur planifikimi paraprak i shpenzimeve vjetore.

Rreziku Hyrja në obligime financiare pa zotim paraprak të mjeteve mund të rezultojë në kosto shtesë si pasojë e mos pagesës me kohë të obligimeve ndaj kontraktorëve në mungesë të mjeteve buxhetore. Po ashtu, kjo mund të rrit obligimet për vitet pasuese.

Rekomandimi 7 Kryetari i Bordit duhet t’i forcojë kontrollet e prokurimit dhe të shpenzimeve për të siguruar që lidhja e kontratave të bëhet vetëm pas zotimit të mjeteve dhe në pajtim me kërkesat tjera ligjore dhe udhëzuesit përkatës.

Çështja 8 - Menaxhimi i automjetit zyrtar - Prioritet i mesëm

E gjetura Në auditimin e një dosje të automjetit kemi identifikuar se informatat e evidentuara në regjistrin rreth shfrytëzimit të automjetit nuk ishin të plota dhe të sakta. Kishte kërkesa për shfrytëzim të automjetit që nuk ishin evidentuar në raportin mujor, ndërsa në disa raste evidencat e shfrytëzimit të prezantuara në raport nuk ishin mbështetur me kërkesa për shfrytëzim.

Rreziku Mungesa e një procesi të dokumentuar plotësisht të autorizimeve dhe shfrytëzimit të automjeteve mund të rezultojë me përdorime jo zyrtare dhe shpenzime të parregullta që lidhen me përdorimin e automjeteve.

Rekomandimi 8 Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se shfrytëzimi i automjeteve zyrtare bëhet në përputhje me kërkesat e rregullores së brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare. Për secilin automjet zyrtar të shfrytëzuar duhet të mbahet evidencë e plotë dhe e saktë.

3.1.4 Investimet kapitale

ARKEP deri në fund të vitit ka shpenzuar tërë buxhetin për investimeve kapitale. Shpenzimet në vlerë 66,507€ janë dedikuar në avancimin dhe mirëmbajtjen e moduleve softuerike për menaxhimin e spektrit frekuencor. Në raportin e menaxherit të kontratës dhe komisionit të pranimit të punëve/shërbimeve ishte konfirmuar realizimi i projektit sipas kushteve kontraktuale.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas regjistrimit kontabël të thesarit, pasuria neto kapitale ishte në vlerë 698,027€. Pasuria jokapitale dhe materialit shpenzues menaxhohej përmes sistemit e-pasuria. Në fund të vitit ishte bërë inventarizimi apo numërimin fizik si dhe vlerësimi i pasurisë së organizatës. Në pjesën e parë të vitit 2017, ARKEP ka aplikuar zhvlerësimin vjetor dhe të akumuluar për pasurinë jokapitale. Çështja e mbivlerësimit të pasurive të prezantuara në PVF-të e këtij viti është adresuar në nënkapitullin 1.2 të këtij raporti.

3.2.2 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme kanë të bëjnë kryesisht me obligimet e debitorëve lidhur me autorizimet për shfrytëzimin e frekuencave. Vlerën e llogarive të arkëtueshme e përbëjnë bilancet e bartura që nga vitit 2010, ndërsa në fund të vitit 2016 këto llogari ishin 783,037€. Çështja e nënvlerësimit të llogarive të arkëtueshme në PVF-të e këtij viti është adresuar në nënkapitullin 1.1 të këtij raporti.

3.3 Obligimet e papaguara

ARKEP ka menaxhuar si duhet obligimet ndaj furnitorëve. Faturat janë nënshkruar dhe protokolluar me rastin e pranimin të furnizimeve dhe shërbimeve dhe pagesa e obligimeve është bërë brenda afatit ligjor për pagesë. Vlera e mbetur e obligimeve në fund të vitit ishte paguar në fillim të vitit pasues.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2. Qeverisja.	Të sigurohet se është zbatuar një rishikim i listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i çështjeve të theksuara. Miratimi i statutit dhe rregullores se re të punës duhet të konsiderohet prioritet, po ashtu edhe ndryshimet në pozita të reflektohen në skemën organizative.		Në proces të zbatimit.	
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut.	Të delegohet përgjegjësia për menaxhimin e rrezikut dhe të sigurohet raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.	Po		
3.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit.	Performanca buxhetore të monitorohet në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar.	Po		
3.5 Kompensimet	Kërkesat për kompensimet e stafit në organizatë të përmbushen në përputhje me rregullat ligjore.		Në proces të zbatimit.	
3.6 Të Hyrat	Softueri me të cilin bëhen llogaritjet në mënyrë automatike sa i përket frekuencave dhe dhënien e autorizimeve të funksionalizohet. Gjithashtu, programi për të hyrat duhet të funksionalizohet me qëllim të ruajtjes së informatave dhe raportimeve të sakta.		Në proces të zbatimit.	

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
REGULATORNI AUTORITET ZA ELEKTRONSKE I POŠTANSKE KOMUNIKACIJE
REGULATORY AUTHORITY OF ELECTRONIC AND POSTAL COMMUNICATIONS

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Kreshnik Gashi,

Kryetar i Bordit

Data:

02/06/2017

